



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

KRYETARE

Nr. 484/1 Prot.

Shkodër, më 04.01.2024


V E N D I M

Nr.21, Datë 28.12.2023

“Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 28/12/2023, me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 9 pika 1.3, germa “C”, neni 14,34,38,40,41,77germa ‘dh’ të Ligjit Nr. 139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 6 të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu III, neni 21, kreu IV, kreu VII, nenet 39-40 të Ligjit nr.68/2017”Për Financat e Vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar,Udhëzimin e ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23,datë 30.07.2018”Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të NJQV”, Udhëzimin Nr.6, datë 28.02.2023 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2024-2026”, Udhëzimin nr.21, datë 07.07.2023 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e buxhetit vendor 2024-2026”, me anekset plotësuese, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018” Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit “, Ligjin Nr.97 Datë 07.12.2023 “Per Buxhetin e Vitit 2024”, Relacionin e Buxhetit të vitit 2024, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **15 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,**

V E N D O S I ;



Të miratojë Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024 si dhe Programin Buxhetor Afatmesem 2024-2026, si më poshtë:

- a) Të miratojë Fondet Buxhetore Totale të parashikuara për vitin 2024, sipas tabelës nr.1, pjesë e këtij vendimi.
 - b) Të miratojë fondet sipas Programeve Buxhetore për vitin 2024 të ndara në korrente dhe kapitale sipas tabelës 2 (Transferte e Pakushtezuar dhe të Ardhura të vitit 2024), si dhe për vitet 2025 e 2026, pjesë e këtij vendimi.
 - c) Të miratojë planin e të ardhurave të detajuar për vitin 2024, sipas tabelës nr.3.
 - d) Të miratojë të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit sipas zërave kryesorë për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme buxhetore, sipas tabelës nr. 4
 - e) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike, për vitet 2024-2026, sipas tabelës nr. 5
 - f) Të miratojë numrin e punonjësve sipas tabelës nr.6 , pjesë e këtij vendimi.
2. Fondet e papërdorura në fund të vitit 2023, me burim financimi transferta e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2024 dhe do të rishpërndahen sipas paragrafit IV, të relacionit të Buxhetit të vitit 2024.
 3. Investimi "Rikonstruksion i rrugës Trush i Poshtëm, Bashkia Vau Dejës", do të jetë bashkëfinancim me Bashkinë Vau Dejës dhe shuma që do të transferohet nga kjo bashki, do të përdoret për këtë investim në vitin 2024.
 4. Është në kompetencë të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër;
 - Rishpërndarja e Projekteve të Investimeve , brënda të njëjtit Program.
 - Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brënda të njëjtit Program.
 5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër.
 6. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARE

Marina DUHANI

